



Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Bazuar në nenin 4 në lidhje me nenin 13 të Rregullores MF-Nr-00/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve si dhe Vendimin e KK-së Nr. 284/17 dt. 28.09.2017 për ridestinimin e mjeteve nga fondi për transfere dhe subvencione, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport me datën **2 nëntor 2017** bën këtë:

THIRRJE PUBLIKE PËR APLIKIM

Komuna e Vushtrrisë, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, përmes kësaj shkrese ju bënë **Thirrje Publike për Aplikim** të gjitha OJQ-ve të interesuara me qëllim të realizimit të projektit “**Ngjyrosja e Hapësirave Publike- Muraleve**” në Qytetin e Vushtrrisë.

Qëllimi i kësaj thirrjeje është që të përzgjidhen idetë më të mira dhe kreative për ngjyrosjen e hapësirave publike - muraleve, implementimi i të cilave do të mbështetet nga DKRS-ja, e cila ka siguruar të gjitha materialet e nevojshme.

Të gjitha OJQ-të e interesuara për aplikim duhet t’i plotësojnë këto kriteret:

- Të jenë OJQ të regjistruara në Republikën e Kosovës;
- Fushëveprimtaria e OJQ-ve që aplikojnë të jetë kulturore;
- Të bashkëngjiten dokumentacionet (certifikata e regjistrimit, xhirollogaria bankare, kopja e letërnjoftimit e përfaqësuesit ligjor);
- Përfituesi eventual, obligohet që para nënshkrimit të kontratës për projektin në fjalë të përmbyll raportet financiare në rast të realizimit të ndonjë projekti paraprak;
- Aplikuesit obligohen të paraqesin idetë e skicuara (autentike) që do të implementohen në lokacionet në fjalë (sipas fotove të cilat gjenden në shtojcën e kësaj thirrjeje publike) si dhe të jap një përshkrim të domethënies dhe mesazhit që përçojnë përmes atij murali;
- Të paraqitet numri i pjesëmarrësve që do të angazhohen për realizimin e projektit.

Specifikat tjera të thirrjes publike:

- Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen;
- Thirrja publike për aplikim hapet me datën 2 nëntor dhe mbyllet me datën 16 nëntor;
- Aplikacionet do të vlerësohen nga Komisioni Vlerësues i cili do të përcaktohet me vendim të Kryetarit të Komunës;
- Implementimi i këtij projekti do të monitorohet nga personi përgjegjës i përcaktuar nga DKRS;
- Periudha e implementimit të këtij projekti fillon nga data 25 nëntor deri në muajin mars të vitit 2018;
- OJQ-ja fituese do të shpërblehet në shumën prej njëmijë e shtatëqind euro.


Mënyra e aplikimit:

1. Dorëzimi i aplikacioneve bëhet në zarfe të mbyllur, ku brenda zarfit vendoset një kopje e printuar e të gjithë dokumentacionit origjinal të kërkuar, si dhe një kopje elektronike në CD;
2. Aplikacionet merren në Zyrën e pranimit ku në të njëjtën edhe duhet të dorëzohen.

Bashkangjitur me Thirrjen Publike Për Aplikim janë:

- ***Fotografitë e lokacioneve, ku do të realizohet projekti;***
- ***Formulari për përshkrimin e projektit/programit.***







Republika e Kosovës



Komuna Vushtrri

Formular për aplikim

Emri i OJQ-së: _____

Numri i regjistrimit: _____

Numri fiskal: _____

Fushëveprimtaria: _____

Data e themelimit të OJQ-së: _____

Personi kontaktues : _____

Nr. i tel: _____

E-maili: _____

Numri i projekteve të realizuara deri më tani:

Përshkrim i realizimit të projekteve të mëparshme (dëshmi përmes fotografive, videove):

Përshkrimi i detajuar i ideve të skicuara:

